



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



NDËRMJETËSIMI

Shumë shpesh njerëzit mendojnë se forma e vetme dhe më e zakonshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve është duke u drejtuar gjykatës e cila merr një vendim gjyqësor për çështjen, duke zbatuar procedurat ligjore.

Mirëpo, jo çdo mosmarrëveshje duhet detyrimisht të zgjidhet në Gjykatë. Palët në një mosmarrëveshje shpesh mund të zgjidhin dallimet e tyre përmes ndërmjetësimit dhe shmangin proceset gjyqësore të gjata, të shtrenjta dhe të pasigurta.

Ndërmjetësimi u siguron qytetarëve, një alternativë të re për zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve të tyre, pa u drejtuar procesit gjyqësor, me kosto shumë më të ulët dhe për një kohë shumë më të shkurtër, transparente, ku janë vetë palët që vendosin në marrjen e vendimit, zgjidhjen e çështjes dhe përmirësimin e raporteve.

Programi i USAID-it Drejtësia Komerciale, mbështet institucionet e Kosovës, siç është Ministria e Drejtësisë, të përgatisë legjislacionin e nevojshëm dhe të ndërtojë infrastrukturën thelbësore për fuqizimin e ndërmjetësimit dhe garantimin e qëndrueshmërisë së tij.

PROVONI NDËRMJETËSIMIN!

Çfarë është ndërmjetësimi?

Ndërmjetësimi është një procedurë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, e rregulluar me ligj, në të cilën kundërshtuesit zgjedhin një ose më shumë persona neutral (“ndërmjetësues”) për t’i ndihmuar palët në arritjen e një zgjidhjeje reciprokisht të kënaqshme. Për dallim nga çështjet gjyqësore, palët mbajnë kontrollin mbi procesin, dhe ndërmjetësuesi nuk merr vendim.

Llojet e kontesteve që mund të zgjidhen përmes ndërmjetësimit:

Ndërmjetësimi është procedurë e rregulluar me Ligjin për Ndërmjetësim dhe zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga fusha e së drejtës civile, komerciale, të punës, familjare, administrative, penale, etj. Gjithashtu ndërmjetësimi mund të aplikohet edhe për një kategori të caktuar të çështjeve penale, për vepra penale me dënim me gjobë dhe burgim deri në tre vjet.

PËR MOSMARRËVESHJET QË MUND TË NDËRMJETËSOHEN, JU NUK KENI NEVOJË T’I DREJTOHENI PARAPRAKISHT GJYKATËS.

Madje edhe kur këto mosmarrëveshje janë paraqitur në gjykatë, gjykatësi do t’i inkurajon dhe fton palët që t’i zgjidhin ato përmes ndërmjetësimit.

Si zhvillohet procedura e ndërmjetësimit?

Ndërmjetësimi iniciohet nga palët, gjyqtarë, prokurorë. Ndërmjetësimi zhvillohet në një mjedis shumë miqësor, kur palët vendosin procedurën, përfshirë kohën dhe kur duhen mbajtur seancat. Në gjykata dhe prokuroritë ju keni staf administrativ për t’ju mbështetur.

Në ndërmjetësim, ndërmjetësuesi lehtëson dhe udhëzon palët se si të arrijnë më lehtë marrëveshje reciprokisht të pranueshme mes palëve dhe nuk ka palë humbëse ose fituese. Ndërmjetësuesi nuk përcakton se kush është fajtor apo si ka ardhur deri tek mosmarrëveshja.

Marrëveshja të cilën palët e arrijnë përmes ndërmjetësimit ka efekte të njëjta sikurse një vendim gjyqësor i formës së prerë, pra marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit përbënë titull ekzekutiv/përmbarimor.

Si mund të kontaktoni/ përzgjidhni Ndërmjetësuesin?

Nëse kërkon një ndërmjetësues për të zgjidhur mosmarrëveshjen tuaj, Ju mund ta gjeni online në Regjistrin e Ndërmjetësuesve në web faqen e Ministrisë së Drejtësisë ose në Zyrat që ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit në kuadër të gjykatave/prokurorive. Një listë e informacionit të kontaktit shfaqet këtu; <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,41>

PËRPARËSITË E NDËRMJETËSIMIT

Pse duhet të zgjidhni Ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes?

Sepse ndërmjetësimi,

- ofron një zgjidhje më të shpejtë- brenda 90 e më së shumti 120 ditëve;
- më pak të kushtueshme se sa procedurat gjyqësore, më transparente dhe më efikase;
- jep mundësinë për të vendosur vetë palët për kushtet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve e jo gjyqtari apo avokati;
- normalizon dhe përmirëson marrëdhëniet midis palëve dhe krijon premisa për vazhdimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me palën tjetër;
- është konfidencial, palët mund të bien dakord që gjithçka e thënë ose bërë mbetet plotësisht konfidenciale;
- mund të zhvillohet menjëherë, sa më shpejt që palët mund të bien dakord për një datë;
- shmang formalitetet e një gjykimi;
- është i suksesshëm deri në 90% të rasteve;
- marrëveshja të cilën palët e arrijnë përmes ndërmjetësimit ka efekte të njëjta sikurse një vendim gjyqësor i formës së prerë. Marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit përbënë titull ekzekutiv/përmbarimor. “Titulli ekzekutiv” është dokument në bazë të cilit fillohet procedura e ekzekutimit;
- palët mund të heqin dorë në çdo kohë nga zgjidhja e mosmarrëveshjes përmes ndërmjetësimit dhe të ndjekin procedurat gjyqësore.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Programi i USAID-it Drejtësia Komeriale
Rr. Lorenc Antoni (Mbreti Zogu), nr.13, Pejton, 10000, Kosovë
Tel: +383 38 609 100